

URDHËR
Nr.194, datë 28.4.2011

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE
PËR KËTO PROGRAME, PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI
PLANETAR I TIRANËS”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.911, datë 26.8.2009 “Për licencimin e shkollës së lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës””,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit të Shkencave të Zbatuara të shkollës së lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”, Tiranë, dhe fillimin e veprimtarisë akademike për programet e reja të studimit, si më poshtë:

a) Programe studimi të ciklit të parë, që realizohen me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:

i) Financë-kontabilitet;

ii) Financë-shkenca juridike.

b) Program studimi i integruar i ciklit të dytë, që realizohen me 300 kredite, me kohëzgjatje normale 5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i Shkencave” në:

i) Farmaci.

2. Këto programe studimi hapen në bazë të vendimit nr.129, datë 3.12.2010 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës” Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj